

A K T - T H E M E L I M I
i shoqërisë tregëtare “GLOB-ENERGY 2024”shpk

Bazuar në ligjin 9901 date 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “GLOB-ENERGY 2024”shpk nga ortaku:

1. Dritan Zaimi, lindur në Durrës më 24.02.1976 dhe banues në Durrës, me nr. ID H60224214E.

Neni 1

Shoqëria tregëtare quhet “GLOB-ENERGY 2024”shpk.

Neni 2

Selia e shoqërisë do të jetë: Durrës, Lagja 4, Rruga Egnatia, Pallati 10, apt 1, Durrës.

Neni 3

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “GLOB-ENERGY 2024”shpk është:

- Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e: Prodhim Energjie nepermjet paneleve solare dhe formave të tjera ekologjike. Import të materialeve elektrike të nevojshëm për prodhimin dhe ndertimin e parqeve fotovoltaik.

Shoqëria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim si dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore.

Neni 4

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë do të jetë pa kufizim.

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është caktuar 100 (njqind) lekë.



Neni 6

Organet e shoqërisë janë:

1. Asambleja e ortakëve
2. Administratori.

Neni 7

Administrator i shoqërisë "GLOB-ENERGY 2024" shpk për një periudhë 5-vjeçare do të jetë Znj. Rovena Zaimi.

Neni 8

Shoqëria ka të drejtë të hyjë në marrdhënie ekonomike e financiare me persona fizikë e juridikë, vëndas e të huaj mbi bazën e kontratave dhe bazuar në legjislacionin shqiptar.

Neni 9

Në rast prishje të shoqërisë, asambleja e ortakëve cakton një likuidator i cili në fund të likuidimit paraqet bilancin e likuidimit.


Neni 10

Ky akt-themelimi përpilohet në 3(tre) kopje me vlerë të barabartë sejcili.

Lexuar, nënshkruar

ORTAKU

Dritan Zaimi



Tiranë, më 08.04.2024



STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“GLOB-ENERGY 2024”shpk

Kapitulli I

EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 - Forma

Bazuar në ligjin 9901 date 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “GLOB-ENERGY 2024”shpk nga ortaku:

A. Dritan Zaimi, lindur në Durrës më 24.02.1976 dhe banues në Durrës, me nr. ID H60224214E.

- 1.1. Shoqëria “GLOB-ENERGY 2024”shpk është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe aktiviteti i saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
- 1.2. Shoqëria vepron sipas ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”.
- 1.3. Shoqëria ka vulën dhe logon e saj zyrtare.

Neni 2 - Emri

- 2.1 Emri i Shoqërisë është “GLOB-ENERGY 2024” shpk.

Neni 3 - Objekti

- 3.1. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si vijon:
 - Prodhim Energjie nepermjet paneleve solare dhe formave te tjera ekologjike. Import te materialeve elektrike te nevojshem per prodhimin dhe ndertimin e parqeve fotovoltaik.Shoqeria mund të ushtrojë gjithashtu edhe aktivitete të tjera ndihmëse në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim si dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore.



- 3.2. Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti.
- 3.3. Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

Neni 4 – Selia

Selia zyrtare e shoqërisë ndodhet ne Durres, Lagja 4, Rruga Egnatia, Pallati 10, apt 1, Durres.

- 4.1. Asambleja e përgjithshme mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë kudo, brënda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 5 – Kohëzgjatja

- 5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë do të jetë pa kufizim.
- 5.2. Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim, me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 6 – Përgjegjësitë

- 6.1. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti.
- 6.2. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emrin e tyre personal ndaj personave të tretë.

Kapitulli II

KAPITALI I SHOQERISE

Neni 7 – Kapitali

- 7.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë si fillim do të jetë 100 (njqind) lekë.



Neni 8 – Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre

- 8.1. Kapitali është i përbërë nga 1(një) kuotë me vlerë 100 (njqind) lekë.
- 8.2. Kuota e kapitalit të shoqërisë zotërohen nga ortakët si më poshtë:
 - Zoti Dritan Zaimi zotëron 100% të kuotës së kapitalit.

Neni 9 – Zmadhimi i kapitalit

- 9.1. Asambleja e përgjithshme mund të rrisë pa kufi kapitalin e Shoqërisë.
- 9.2. Rritja e kapitalit mund të bëhet nëpërmjet financimit të ortakëve ose nëpërmjet përfshirjes në kapital të fitimeve dhe rezervave të shoqërisë.
- 9.3. Administratorët njoftojnë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.
- 9.4. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- 9.5. Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme vendos edhe për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë që me këto fitime të zmadhojë kapitalin e regjistruar, të rrisi rezervat statutores ose të shpërndajë dividend.
- 9.6. Në asnjë rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë pa mbuluar më parë humbjet e rezultuara në pasqyrat financiare.
- 9.7. Në përputhje me nenin 77 të ligjit 9901 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, përpara se të vendoset për shpërndarje dividenti, administratorët lëshojnë certifikatë të aftësisë pague. Kjo certifikatë lëshohet vetëm në se pas pagimit të dividentit, aktivet e shoqërisë i mbulojnë tërësisht detyrimet e saj dhe shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brënda 12 muajve në vazhdim.

Neni 10 – Krijimi i rezervave

- 10.1 Mbas miratimit të pasqyrave financiare, asambleja krijon rezerva statutores. Rezerva statutores mund të jetë për çdo vit deri në 10% e fitimit vjetor. Kur këto rezerva të kapin shumën sa 10% të kapitalit themeltar, asambleja e ortakëve mund të mos krijojë më rezerva.

Neni 11 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar



- 11.1. Asambleja e përgjithshme mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- 11.2. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim, nga administratorët. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 12 – Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes

- 12.1. Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.
- 12.2. Transferimi për çfarëdo arsyeje, tërësisht ose pjesërisht i kuotave të kapitalit të shoqërisë është subjekt i të drejtës së parablerjes, në favor të ortakëve të tjerë, të cilët mund të ushtrojnë këtë të drejtë, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomande, i cili përmban ofertën. Në rast se ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se kanë hequr dorë prej të drejtës së parablerjes.
- 12.3. Në rast se njëri prej ortakëve refuzon apo heq dorë nga ushtrimi i të drejtës së tij të parablerjes, ortakët e tjerë, të cilët tashmë kanë ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes, mund ta ripërdorin këtë të drejtë edhe për pjesën e ofruar ortakut që e refuzoi atë.
- 12.4. Në rast se më shumë se një ortak dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e parablerjes, kuotat e kapitalit të ofruara ortakut që nuk dëshiron ta ushtronte të drejtën e tij, ndahen në proporcion me pjesët e kapitalit respektiv.
- 12.5. Në rast se vetëm njëri prej ortakëve dëshiron ta ushtrojë të drejtën e parablerjes, kuotat e kapitalit të ofruar i transferohet atij tërësisht ose në atë masë që ky ortak dëshiron.
- 12.6. Ortakët që dëshirojnë të ripërdorin të drejtën e tyre të parablerjes duhet t'i njoftojnë vendimin e tyre ortakut që dëshiron të transferojë kuotat e tij të kapitalit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, që prej marrjes së lajmit për mos ushtrimin e së drejtës së parablerjes prej ndonjërit prej ortakëve.
- 12.7. Të gjitha njoftimet e sipërpërmendura do të bëhen me shkrim dhe i adresohen administratorit të Shoqërisë.

Neni 13 - Pasojat e kalimit të kuotave



- 13.1 Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Kapitulli III

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRIMI, KONTROLLI

Neni 14 – Të drejtat dhe detyrimet

- 14.1 Organi më i lartë drejtues i Shoqërisë “GLOB-ENERGY 2024” shpk është asambleja e ortakëve. Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të Shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 15 - Mbledhja e asamblesë së përgjithshme

- 15.1. Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji, dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.
- 15.2. Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e



shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.

- 15.3. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton na pasqyrat financiare të çertifikuara nga eksperti kontabël.
- 15.4. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët.

Neni 16 - Mënyra e thirrjes së asamblesë

- 16.1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi me shkresë duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 16.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 17 - Kërkesa nga ortakët e pakicës

- 17.1. Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të Shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës.

Neni 18 - Përfaqësimi në asamble

- 18.1. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 18.2. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 18.3. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 19 - Kuorumi



- 19.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht.
- 19.2 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 20 - Marrja e vendimeve

- 20.1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 20.2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështjet e tjera.
- 20.3. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

Neni 21 - E drejta e votës

- 21.1. Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.
- 21.2. Ortakët kanë të drejtën, që u njihet nga ligji apo statuti, për të marrë unanimisht çdo vendim, me kusht që kjo marrëveshje të bëhet me shkrim.

Neni 22 - Përjashtimi nga e drejta e votës

- 22.1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - c) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.



22.2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 23 - Procesverbalet e mbledhjes së asamblesë

23.1 Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

23.2. Procesverbali përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

23.3. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

23.4. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit.

Neni 24 - Hetimet e posaçme

24.1 Asambleja e përgjithshme mund të vendosë nisjen e një hetimi të posaçëm për parregullsitë përgjatë veprimeve të themelimit të Shoqërisë apo të ushtrimit të veprimtarisë tregtare, ne perputhje me rregullat e percaktuara ne nenin 91 te Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 “Per tregtarët dhe shoqërite tregtare”.

Neni 25 - Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi

25.1 Asambleja e përgjithshme ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorit, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit, ne perputhje me rregullat e percaktuara ne nenin 92 te Ligjit Nr. 9901, date 14/04/2008 “Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 26 – Administrimi

26.1. Shoqëria administrohet nga administratori. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë ripërtëritjeje. Administratore e shoqërisë “GLOB-ENERGY 2024” shpk për një periudhë 5-vjeçare, duke filluar nga data e miratimit të këtij statuti, do të jenë znj. Rovena Zaimi.

26.2. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:



- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

26.3. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë, me shumicë të zakonshme.

Neni 27 - Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia

27.1 Administratori detyrohet të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi. Administratori përgjigjet ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale.

Kapitulli IV

SHPËRNDARJA E FITIMIT

Neni 28 - Shpërndarja e fitimeve

28.1 Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të shoqërisë. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Kapitulli V

PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 29 - Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;



- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk kryen veprimtari tregtare për dy vjet ;
- d) me vendim të gjykatës;

Neni 30 - Largimi i ortakut për shkaqe të arsyeshme

30.1 Ortaku mund të largohet apo perjashtohet nga shoqëria në kushtet dhe sipas procedurave të percaktuara në Ligjin Nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 31 – Amendamentet

31.1 Këtë statut mund t’i bëhen amendamente sa herë që asambleja e shëh të arsyeshme. Për amendamentet, asambleja duhet të vendosë sipas përcaktimeve që bën ligji.

Ky statut hartohet në 3(tre) kopje në gjuhën shqipe.

ASAMBLEA E ORTAKËVE

Dritan Zaimi

Dritan Zaimi


Tiranë, më 08.04.2024